



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
REKTORATI

Nr. 11615 Prot.

Vlorë më, 22 . 04 .2026

VENDIM

Nr. 16, datë 22 / 04 / 2026

PËR

**MIRATIMIN E PROJEKT-PROPOZIMEVE TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE  
TEKNIKE DHE NATYRORE, NË KUADËR TË PROGRAMIT TË KËRKIM-  
ZHVILLIMIT (PKZHUV), TË FINANCUARA NGA BUXHETI I UNIVERSITETIT  
"ISMAIL QEMALI", VLORË, PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 93, 95, pika 1, 2, 3, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 26, pika 3, dhe kreut IX të Statutit të UV-së; nenit 8, pika 6, 7 dhe 8, të Rregullores për Projektet të Kërkim-Zhvillimit të financuara nga buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; vendimit të Senatit Akademik të UV-së nr. 16, datë 06.05.2021, si dhe referuar shkresës së Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, me nr. 1004/1 prot., datë 16.04.2026; Rektorati, në mbledhjen e datës 22.04.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë projekt-propozimet me financim nga Buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë (PKZHUV), të paraqitur nga Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, si më poshtë:

- Studim mbi potencialin e reduktimit të CO2 nga energjia elektrike bregdetare në portin/et detare të Vlorës
- Biodiversiteti në rrethin e Vlorës: Nga evidencat shkencore drejt orientimit strategjik.
- Analiza e faktorëve përcaktues të vendimmarrjes së studentëve për regjistrimin në programet Master: Evidenca nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.
- Vlerësimi I integruar I Mikroplastikave dhe Metaleve të Rënda në Sistemin Lumor-Lagunar Vjosë-Nartë: Shpërndarja dhe Rreziku Ekologjik.
- Forcimi I tranzicionit gjimnaz-universitet dhe orientimi I gjimnazistëve drejt Festivalit të Shkencës dhe studimeve në Shkencat Natyrore dhe Matematikë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
**REKTORATI**

- Zhvillimi I nje sistemi inteligjent për monitorimin dhe analizën e mungesave të studentëve me QR kod.
  - Analiza e Fluksit të Trafikut të Bazuar në të Dhëna dhe Optimizimi Inxhinierik për Lëvizshmëri të Qëndrueshme Urbane në Vlorë.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike në UV.
  3. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**REKTOR**  
**Prof.Dr. Aurela Saliaj**

